




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Bruto produktit vendor në qasjen e shpenzimeve (2004-2011)



P a r a t h ë n i e

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përpiluar të dhënat e Bruto Produktit Vendor (BPV) për vitët 2004-2011, me qasjen e shpenzimeve me çmime aktuale dhe konstantë. BPV është përlogaritur në bazë të parimeve metodologjike të Sistëmit Evropian të Llogarive ("European System of Accounts" - ESA 95 dhe SNA 2008).

Të dhënat nga Llogaritë Kombëtare përdoren për planifikim ekonomik dhe fiskal dhe për elaborimin e programeve të zhvillimit për sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Rezultatët nga llogaritë kombëtare përdoren po ashtu nga investitorët e vendit dhe të huaj, për të vlerësuar situatën ekonomike të shtetit dhe mundësitë për investime të reja.

ASK do të vazhdojë zhvillimin e Llogarive Kombëtare në pajtim me rekomandimet ndërkombëtare dhe do të publikojë të dhëna kualitative dhe me kohë.

Falënderojmë Zj. Natalia Ivanik, eksperte e FMN-së.

Publikimin e përgatitën:

Ilir T. Berisha-drejtor i departamentit
Xhevrie Fetahu-shefe e divizionit
Ylli Shala-zyrtar i lartë
Ilir Mazrekaj-zyrtar i lartë
Emine Bajrami-zyrtare e lartë
Florije Krapa-zyrtare e lartë
Nysret Sylejmani zyrtar i lartë

Prishtinë, Shtator 2012

Kryeshef Ekzekutiv i ASK,
Z. Isa Krasniqi

Para th ënie

	Faqe
Bruto produkti vendor me qasjen e shpenzimeve 2004-2011	3
Tabela 1: Bruto Produkti Vendor me çmime aktuale 2004-2011	3
Graf. 1.1. BPV për kokë banori	4
Tabela 2: Struktura e BPV sipas shpenzimeve.....	5
Graf. 2.1 Pjesëmarrja e komponentëve në BPV 2010-2011	6
Tabela 3: BPV me çmime konstantë (me çmimet e vitit paraprak)	7
Graf. 3.1 Norma reale e rritjes	8
Shënime metodologjike.....	10
Pjesët përbërëse të Bruto Produktit Vendor	10

Bruto produkti vendor me qasjen e shpenzimeve 2004-2011

Treguesi kryesor dhe më i rëndësishëm makroekonomik në Sistëmin e Llogarive Kombëtare është Bruto Produkti Vendor (BPV), i cili paraqet rezultate finale të prodhimit në të gjitha aktivitetet e njësive prodhuese rezidentë.

Kalkulimi i Bruto Produktit Vendor bazohet në metodologjinë e SNA 2008 dhe ESA 95 dhe shtrëtzon burimet e të dhënave administrative ekzistuese si dhe në anketat statistikore zyrtare, të cilat realizohen në ASK.

Tabela 1: Bruto Produkti Vendor me çmime aktuale 2004-2011


	(në milion Euro)							
	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
BPV me çmime aktuale	2,911.8	3,002.8	3,120.4	3,460.8	3,940.3	4,007.8	4,291.1	4,776.1
Shpenzimet e konsumit final	3,212.7	3,367.6	3,466.2	3,810.6	4,344.6	4,301.0	4,557.2	5,023.1
Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake	2,487.6	2,638.4	2,770.8	3,145.9	3,646.7	3,605.4	3,821.9	4,219.8
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	701.5	705.5	670.6	641.6	674.4	670.5	709.3	772.3
Qeveria e Kosovës	355.5	329.2	340.8	327.3	372.6	409.7	482.7	545.2
Donatorët (pagat)	346.0	376.3	329.8	314.3	301.8	260.8	226.6	227.0
Të punësuar të huaj	247.8	258.4	213.2	196.9	196.9	178.7	157.4	157.8
Të punësuar vendor	98.2	117.9	116.6	117.4	104.9	82.1	69.2	69.2
Shpenzimet e konsumit final të IJPSHESH	23.5	23.7	24.8	23.1	23.6	25.0	26.0	31.1
Formimi i bruto kapitalit	701.2	722.2	798.3	892.5	1,093.9	1,164.1	1,342.0	1,530.8
Formimi i bruto kapitalit fiks	583.6	592.8	657.1	744.3	937.9	1,026.5	<u>1,192.6</u>	1,374.3
Ndryshimet në inventar	117.7	129.4	141.2	148.3	156.0	137.6	149.4	156.5
Eksporti neto	-1,002.1	-1,087.0	-1,144.1	-1,242.3	-1,498.2	-1,457.2	-1,608.1	-1,777.8
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	310.0	332.8	441.4	<u>547.1</u>	<u>608.9</u>	<u>657.0</u>	<u>835.1</u>	958.9
Eksporti i mallrave	63.8	67.8	122.5	<u>177.2</u>	<u>216.6</u>	<u>177.2</u>	<u>305.0</u>	324.9
Eksporti i shërbimeve	246.2	265.0	319.0	<u>369.9</u>	<u>392.4</u>	<u>479.8</u>	<u>530.1</u>	634.0
Importi i mallrave dhe shërbimeve	1,312.1	1,419.8	1,585.5	<u>1,789.5</u>	<u>2,107.1</u>	<u>2,114.2</u>	<u>2,443.1</u>	2,736.7
Importi i mallrave	1,046.9	1,146.3	1,295.6	<u>1,530.1</u>	<u>1,866.3</u>	<u>1,828.9</u>	<u>2,057.1</u>	2,383.9
Importi i shërbimeve	265.2	273.5	289.9	<u>259.4</u>	<u>240.8</u>	<u>285.3</u>	<u>386.1</u>	352.8
BPV për kokë banori (Euro)¹	1,813	1,834	1,875	2,046	2,291	2,293	2,418	2,650

BPV në Kosovë për vitët 2004-2011 është rritur në vlerën prej 2,911.8 në 4,776.1 milion euro. BPV për kokë¹ banori është rritur prej 1,813 euro në vitin 2004 , në 2,650 euro në vitin 2011.

¹ Kalkulimet e numrit të popullsisë janë kryer në bazë të rezultateve përfundimtare të regjistrimit të popullsisë, duke shtuar edhe numrin e popullsisë për tri komunat veriore.

*Numrat ne italik dhe te nenvizuar jane korigjuar. Për me tepër lexo në **shënim**.

Graf. 1.1. BPV për kokë banori




Siç shihet nga grafi, BPV për kokë banori kishte trend rritës, duke arritur në 2,650 euro per vitin 2011.

Tabela 2: Struktura e BPV sipas shpenzimeve

	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
BPV me çmime aktuale	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0
Shpenzimet e konsumit final	110.3	112.1	111.1	110.1	110.3	107.3	106.2	105.2
Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake	85.4	87.9	88.8	90.9	92.5	90.0	89.1	88.4
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	24.1	23.5	21.5	18.5	17.1	16.7	16.5	16.2
Qeveria e Kosovës	12.2	11.0	10.9	9.5	9.5	10.2	11.2	11.4
Donatorët (pagat)	11.9	12.5	10.6	9.1	7.7	6.5	5.3	4.8
Të punësuar të huaj	8.5	8.6	6.8	5.7	5.0	4.5	3.7	3.3
Të punësuar vendor	3.4	3.9	3.7	3.4	2.7	2.0	1.6	1.4
Shpenzimet e konsumit final të IJPSHESH	0.8	0.8	0.8	0.7	0.6	0.6	0.6	0.7
Formimi i bruto kapitalit	24.1	24.1	25.6	25.8	27.8	29.0	31.3	32.1
Formimi i bruto kapitalit fiks	20.0	19.7	21.1	21.5	23.8	25.6	27.8	28.8
Ndryshimet në inventar	4.0	4.3	4.5	4.3	4.0	3.4	3.5	3.3
Eksporti neto	-34.4	-36.2	-36.7	-35.9	-38.0	-36.4	-37.5	-37.2
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	10.6	11.1	14.1	15.8	15.5	16.4	19.5	20.1
Eksporti i mallrave	2.2	2.3	3.9	5.1	5.5	4.4	7.1	6.8
Eksporti i shërbimeve	8.5	8.8	10.2	10.7	10.0	12.0	12.4	13.3
Importi i mallrave dhe shërbimeve	45.1	47.3	50.8	51.7	53.5	52.8	56.9	57.3
Importi i mallrave	36.0	38.2	41.5	44.2	47.4	45.6	47.9	49.9
Importi i shërbimeve	9.1	9.1	9.3	7.5	6.1	7.1	9.0	7.4

Konsumi Final i ekonomive shtëpiake merr pjesë me 88.4 për qind në BPV për vitin 2011, deri sa në vitin 2010 kishtë një pjesëmarrje prej 89.1 për qind të BPV-së. Formimi i bruto kapitalit ka kontribuar me 32.1 për qind në BPV në vitin 2011. Shpenzimet e qeverisë së përgjithshme në 2011 kanë përfaqësuar 16.2 për qind të BPV-së.

Graf. 2.1 Pjesëmarrja e komponentëve në BPV 2009 - 2011



Siç shihet nga grafiku, në vitin 2011 kishte ndryshime strukturore të pjesëmarrjes së komponentëve kryesore në BPV krahasuar me vitin 2010:

- Konsumi Final i Ekonomive Shtëpiake (KFESH) nga 89.1 % të BPV në vitin 2010 në 88.4% në vitin 2011;
- Konsumi Final i Qeverisë (KFQ) nga 16.5% të BPV në vitin 2010 në 16.2 % në vitin 2011;
- Formimi i Kapitalit Bruto (FBK) nga 31.3 % të BPV në vitin 2010 në 32.1% në vitin 2011;
- Eksporti Neto nga – 37.5% të BPV në vitin 2010 në – 37.2 në vitin 2011.


Tabela 3: BPV me çmime konstante (me çmimet e vitit paraprak)

(në milion Euro)

	2006	2007	2008	2009	2010	2011
BPV me çmime aktuale	3,105.1	3,379.4	3,710.7	4,077.0	4,136.5	4,486.0
Shpenzimet e konsumit final	3,429.5	3,718.8	4,087.1	4,382.0	4,381.6	4,645.8
Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake	2,746.5	3,048.1	3,416.7	3,722.3	3,715.9	3,936.7
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	658.6	648.0	647.3	635.2	640.5	680.2
Qeveria e Kosovës	333.6	338.3	350.0	378.2	421.6	460.8
Donatorët (pagat)	324.9	309.7	297.3	257.0	218.9	219.3
Shpenzimet e konsumit final të IJPSHESH	24.5	22.7	23.1	24.5	25.1	29.0
Formimi i bruto kapitalit	753.2	830.8	1,028.9	1,211.1	1,307.5	1,494.3
Formimi i bruto kapitalit fiks	621.1	692.8	885.1	1,065.5	1,156.8	1,336.4
Ndryshimet në inventar	132.1	137.9	143.8	145.6	150.8	157.9
Eksporti neto	-1,077.6	-1,170.1	-1,405.2	-1,516.1	-1,552.6	-1,654.1
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	420.7	509.4	548.0	682.5	742.3	919.3
Eksporti i mallrave	103.8	155.4	189.1	190.9	230.2	306.7
Eksporti i shërbimeve	317.0	354.0	358.8	491.6	512.2	612.6
Importi i mallrave dhe shërbimeve	1,498.4	1,679.6	1,953.2	2,198.6	2,295.0	2,573.4
Importi i mallrave	1,214.7	1,425.5	1,720.1	1,914.1	1,915.0	2,240.6
Importi i shërbimeve	283.7	254.1	233.1	284.4	380.0	332.8
BPV - Norma reale e rritjes	3.4	8.3	7.2	3.5	3.2	4.5

Norma reale e rritjes së Bruto Produktit Vendor (BPV) në Kosovë ishte 4.5% në vitin 2011 në krahasim me vitin 2010.

Graf. 3.1 Norma reale e rritjes



Shenim:

Numrat në italic dhe të nënvizuar janë korigjuar për shkak të ndryshimit të të dhënave të Bilancit të Pagesave (dhjetor 2011) nga BQK-ja për vitet 2007- 2010. Keto ndryshime ndikuan në rritjen e BPV me çmime aktuale dhe konstante për vitet e cekura.

Ndryshimi tjetër është edhe për shkak të të dhënave të Formimit Bruto Kapitalit Fiks per vitin 2010.

Të gjitha këto ndryshime janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Vitet	BPV me çmime aktuale (ne mil)		BPV me çmime konstante (ne mil)		Norma reale e rritjes së BPV-së	
	para korigjimit	pas korigjimit	para korigjimit	pas korigjimit	para korigjimit	pas korigjimit
2007	3,393.7	3,460.8	3,315.8	3,379.4	6.3	8.3
2008	3,851.4	3,940.3	3,628.1	3,710.7	6.9	7.2
2009	3,912.4	4,007.8	3,962.7	4,077.0	2.9	3.5
2010	4,215.6	4,291.1	4,063.4	4,136.5	3.9	3.2

Shënime metodologjike

BPV llogaritet sipas tri qasjeve:

- Qasja e prodhimit
- Qasja e shpenzimeve dhe
- Qasja e të ardhurave

Qasja e shpenzimeve:

Bruto produkti vendor (BPV) sipas qasjes së shpenzimeve është shuma e të gjitha shpenzimeve finale të mallrave dhe shërbimeve. Këto shpenzime ndahen në tri grupe kryesore : konsumi final, formimi i kapitalit bruto dhe neto eksporti dhe importi (E-I). Meqë bruto prodhimi vendor (BPV) matë prodhimin e brendshëm, vlera e të gjitha shpenzimeve të importit zbritët nga të gjitha shpenzimet duke përdorë formulën:

$$BPV = KF + FKB + (E-I)$$

KF = konsumi final

FKB = formimi i kapitalit bruto

E = eksporti

I = importi

Pjesët përbërëse të Bruto Produktit Vendor

1. Konsumi final i ekonomive shtëpiake

Konsumi final i ekonomive shtëpiake është komponenti kryesor i Bruto Produktit Vendor me qasjen e shpenzimeve dhe paraqet shpenzimet e ekonomive shtëpiake rezidente, me qëllim të plotësimit të nevojave dhe kërkesave të tyre për mallra dhe shërbime. Kjo nuk nënkupton vetëm mallrat dhe shërbimet e paguara direkt, por gjithashtu edhe marrjen e tyre edhe në natyrë ose nga prodhimi vetanak.

Vlerësimi i shpenzimeve të ekonomive shtëpiake është bazuar në të dhënat e anketës së buxhetit të ekonomive shtëpiake. Kjo anketë organizohet në ASK.

2. Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë së Përgjithshme

Konsumi final i Qeverisë përbëhet nga shuma e mallrave dhe shërbimeve të blera, kompensimi i punëtorëve dhe konsumit të kapitalit fiks, i zvogëluar për të hyrat nga shitjet.

3. Formimi i bruto kapitalit

Bazuar në metodologjinë e ESA 95, formimi i bruto kapitalit paraqet shumën e formimit të bruto kapitalit fiks dhe ndryshimeve në inventar.

Vlerësimi i formimit të bruto kapitalit fiks përfshinë posedimin e të gjitha asetëve të prekshme dhe përmirësimet kryesore në asete të prekshme të cilat përdoren më shumë se një vit. Vlerësimet e FBKF përfshijnë këto lloje të aseteve: banesat, ndërtësat tjera dhe strukturën, makinerinë dhe pajisjet.

Burimi kryesor i të dhënave për investime janë të dhënat nga importi për makineri dhe pajisje. Këto të dhëna po ashtu plotësohen me të dhëna nga prodhimi vendor i materialit ndërtimor.

Ndryshimet në inventar matën me vlerën e hyrjes së mallit në inventar, të zvogëluar për vlerën e tërheqjes dhe të ndonjë dëmi të shkaktuar në atë mall gjatë mbajtjes së tij në inventar. Vlerësimi i ndryshimeve në inventar është bazuar në rezultatet e Anketës strukturore të ndërmarrjeve, e realizuar nga ASK.

4. Konsumi final i institucioneve jo profitabile të cilat i'u shërbejnë ekonomive shtëpiake

Institucionet jo profitabile të cilat i'u shërbejnë ekonomive shtëpiake përbëhen nga organizatat jo qeveritare(OJQ).

5. Importi dhe eksporti i mallrave dhe shërbimeve

Eksporti i mallrave dhe shërbimeve përfshinë transaksionet e mallrave dhe shërbimeve nga rezidentet tek jo rezidentët.

Importi i mallrave dhe shërbimeve përfshinë transaksionet e mallrave dhe shërbimeve nga jo rezidentet tek rezidentët.

Të dhënat e eksportit dhe importit të mallrave janë marrë nga Dogana e Kosovës, ndërsa të dhënat e eksportit dhe importit të shërbimeve janë marrë nga Bilanci i pagesave (BOP), i elaboruar në Bankën Qendrore të Kosovës(BQK).

Burimet e të dhënave

a) Burimet statistikore të të dhënave

- Rezultatët e anketave të kryera nga ASK, si: anketa e buxhetit të ekonomive shtëpiake, anketa e fuqisë punëtore, anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore dhe publikimet e ndryshme të ASK;
- Të dhënat e tregtisë së jashtme : importi dhe eksporti i mallrave;
- Indeksi i çmimeve të konsumit dhe indekset tjerë të çmimeve të përlogaritur nga ASK;
- Indeksi i vlerës njësi, i cili përdoret për eksport dhe import.
- Rezultatet përfundimtare të regjistrimit të popullsisë 2011

b) Burimet administrative:

- Ministria e Financave, të dhënat e buxhetit dhe të thesarit;
- Banka Qendrore e Kosovës, të dhënat e Bilancit të pagesave;
- Ministria e Administratës Publike të dhënat e OJQ-ve;
- Ministria e Bujqësisë për disa të dhëna të bujqësisë;
- Administrata tatimore e Kosovës –të dhënat për tatimet

c) Burime tjera:

- Deflatorët e shtetëve fqinjë dhe
- ICP të vendeve të Eurozonës për tregun e shtetëve jashtë BE-së

Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: **Departamentet prodhuese;** (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të popullsisë, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. **Departamentet mbështetëse;** (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti i administratës. **Në kuadër të Agjencionit vepron edhe;** Zyra për regjistrimin e popullsisë ekonomike familjare dhe banesave si dhe **Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 134 punëtorë, prej tyre, 96 (71.6%) në seli të Entit, gjersa në Zyrat Rajonale, 38 (28.4%), Enti ka ketë strukture kualifikuese, 65.4% me shkollim universitar ndaj 34.6% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Kemi realizuar me sukses në vitin 2011 projektin e Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe banesave, i cili regjistrim nuk është realizuar që nga viti 1981. Rezultatet e fituara nga ky regjistrim do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- o **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- o **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 143
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- o **Fax::** +381 (0) 38 235 033
- o **E-mail:** economic@ks-gov.net
- o **Ueb-faqe:** <http://esk.rks-gov.net>